

**EKR Taulant Asllani**

**Likuidator**

Adresa: Njësia Bashkiake Nr. 7, Rruga Sami Frashëri, Pallati Tid, Shkalla 2, Apartamenti 1, Tiranë

Tel: +355 69 94 44 920

Email: [tasllani@tiranafinancialauditors.com](mailto:tasllani@tiranafinancialauditors.com)

**RAPORT I LIKUIDATORIT**  
**PËR LIKUIDIMIN PËRFUNDIMTAR TË SHOQËRISË ALBANIA 2017 SH.P.K.**  
**(L71605063O)**

**Drejtuar: Z. Aleksandër Frangaj, Ortak i vetëm i Shoqërisë ALBANIA 2017 sh.p.k. (L71605063O)**

**Tiranë, më 10/08/2020**

Shoqëria **ALBANIA 2017 sh.p.k.** është krijuar datë **05/04/2017** pranë Qendrës Kombetare të Biznesit me NUIS L71605063O. Aktiviteti kryesor i saj është: Ndërtim dhe Projektim. Importi - eksporti, shitja me shumicë e pakicë e produkteve tekstile, veshjeve të të gjitha llojeve, shitja me shumicë e pakicë e mallrave industriale e ushqimore. Tregëtimi i artikujve të ndryshëm, importi/eksporti; shitja me shumicë e pakicë e pajisjeve elektrike, elektronike, lënde të parë për industrinë, materiale ndërtimi e hidrosanitare, pajisje zyrash, kancelari, pjesë këmbimi auto e makineri te çdo lloji, pajisje teknologjike etj. Shitja, blerja dhënia me qira e pasurive te paluajtshme. Transporti i mallrave dhe udhëtareve brenda dhe jashtë vendit, menaxhimi i qendrave tregtare, bareve, restorante, ofrimi i shërbimit të konsulencës në fushën e biznesit, menaxhimit, taksave etj. Punime për ndërtimin e serave dhe objekteve në shërbim të aktiviteteve bujqësore për prodhimin dhe ruajtjen e produteve të ndryshme bujqësore, si dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to. Si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë e që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptare në fuqi.

Me vendimin e ortakëve, me objekt fillimin e procedurave të likuidimit të Shoqërisë, jam emëruar si likuidator dhe mu kërkua të kryej procedurat e likuidimit të saj.

Procedurat e likuidimit si dhe pasqyrat financiare të likuidimit të Shoqërisë janë bërë, duke pasur parasysh realizimin e ketyre qëllimeve:

- 1) Te realizohet shitja e aktiveve.
- 2) Të arketohen kërkesat për arkëtim dhe të drejta të tjera të Shoqërisë nga të tretët.
- 3) Të bëhet shlyerja e plotë e detyrimeve ndaj të tretëve.
- 4) Aktiviteti neto, mbas shlyerjes së detyrimeve t'u shpërndahen drejt ortakut të Shoqërisë.
- 5) Rezultati i likuidimit të paraqitet në mënyrë të besueshme dhe të sinqertë.

Në përfundim ju relatojmë juve se procedurat e sipërpërmendura i kemi realizuar në këtë mënyrë:

- 1) **Shitja e aktiveve:** Sipas bilancit të marrjes në dorëzim për fillimin e procedurave të likuidimit Shoqëria nuk kishte në pronësi të saj aktive të cilat mund të shiteshin.
- 2) **Arkëtimi i kërkesave për arkëtim nga të tretët:** Sipas bilancit të marrjes në dorëzim për fillimin e procedurave të likuidimit Shoqëria nuk kishte kërkesa për arkëtim ndaj të tretëve.
- 3) **Shlyerja Te pagueshme ndaj punonjesve:** Në datën e këtij raporti Shoqëria ka shlyer plotësisht detyrimet ndaj punonjesve. Keto detyrime u shlyen pjesërisht me mjetet monetare në dispozicion dhe pjesërisht nëpërmjet financimit nga ortaku i vetëm.
- 4) **Shlyerja e detyrimeve Tatimore:** Në datën e këtij raporti Shoqëria ka shlyer plotësisht detyrimet tatimore. Keto detyrime u shlyen nëpërmjet financimit nga ortaku i vetëm.
- 5) **Shlyerja Kreditorëve të tjerë:** Në datën e këtij raporti Shoqëria ka shlyer plotësisht detyrimet Kreditorëve të tjerë. Këto detyrime u shlyen nëpërmjet financimit nga ortaku i vetëm.



- 6) **Shpërndarja e aktiveve neto:** Shoqëria kishte humbje të mbartura. Pas kryerjes së procedurave të likuidimit kapitali neto i shoqërisë mbetet zero.


Përpilimi i pasqyrave financiare të likuidimit përfundimtar. Në përfundim u hartuan pasqyrat financiare të likuidimit përfundimtar të Shoqërisë dhe ju paraqiten asamblesë së aksionerëve për ti aprovuar. Procedurat e likuidimit kanë qenë transparente, të sinqerta e të besueshme. Pasqyrat financiare të likuidimit janë hartuar konform rregullave dhe normave kontabile të parashikuara nga Standartet Kombetare të Kontabilitetit.

Ne besojme se qëllimi i misionit të marrë përsipër u realizua në të gjitha këto pika. Kështu u përgatit edhe Bilanci përfundimtar i likuidimit.

Me aprovimin e këtij raporti asambleja e ortakeve vec te tjerash ka aprovuar:

1. Detyrimin e saj për të mbuluar detyrimet eventuale që mund të dalin në të ardhmen, të cilat nuk ishin të evidentuara në bilancin e likuidimit, ose për të cilat nuk pati kërkesa nga kreditorët gjatë periudhës së likuidimit, siç mund të jenë detyrime për tatime dhe taksa qoftë nga organet tatimore apo lokale.
2. Aprovimin e dorheqjes së likuidatorit Taulant Asllani që nga ky moment, dhe nëse procesi i likuidimit bllokohet për mos shlyerje detyrimesh prej Shoqërisë, asambleja duhet të caktojë një likuidator tjetër, ose në të kundërt Shoqëria kthehet nga Shoqëri në Likuidim e sipër në një Shoqëri me aktivitet normal ku ortaku merr drejtimin e Shoqërisë si Administrator.

Partneri i Angazhimit, rezultat i të cilit është ky raport likuidimi është **Taulant Asllani**.



10 Gusht, 2020



ALBANIA 2013

Spisek

№ 12 : 1.1002003 O

Territ. Albanië